



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
MINISTRI

Nr. 1370 / prot.
16

Tiranë, më 15.05.2020

URDHËR

Nr. 323, datë 15.05.2020

PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT TË MINISTRIT NR. 156/4, DATË 28.03.2020 “PËR KALIMIN E SPITALIT UNIVERSITAR “SHEFQET NDROQI” NË SPITAL COVID-2, PËR TRAJTIMIN E PACIENTËVE TË INFEKTUAR ME COVID-19 DHE TRAJTIMIN E TË SËMURËVE PULMONARË NË SPITALIN RAJONAL ELBASAN”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 113 të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e Urdhrit nr. 156/4, datë 28.03.2020 “Për kalimin e Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi” në spital Covid -2, për trajtimin e pacientëve të infektuar me Covid-19 dhe trajtimin e të sëmurëve pulmonarë në Spitalin Rajonal Elbasan”.
2. Spitali Rajonal Elbasan dhe Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” të marrin masat për transferiminin e pacientëve që kanë patur nevojë për hospitalizim për sëmundje pulmonare, dhe për organizimin e shërbimeve duke siguruar shërbimet sipas protokolleve klinike të miratuara.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Spitali Rajonal Elbasan, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”, Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ogerta Manastirliu

